



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, dërguar me anë të postës elektronike në datë 06.02.2024, dhe regjistruar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 829 Prot., datë 06.02.2024, në bazë të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju informojmë si më poshtë vijon:

Me Urdhrin nr.42, të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, është ngritur Grupi i Punës “Për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata” i ndryshuar. Gjatë veprimtarisë së tij, grupi i punës asistohet nga ekspertë vendas dhe të huaj, të cilët janë ftuar të japin kontributin e tyre në funksion të objektivave të këtij grupi pune, për analizimin e situatës, identifikimin e shkaqeve të krijimit të stokut, si dhe në hartimin e planit konkret për uljen e numrit të çështjeve të parapambetura në gjykata.

Duke patur parasysh volumin e konsiderueshëm e të dhënave të cilat duhet të analizohen dhe të përpunohen, mbi propozimin e ekspertëve, është vlerësuar zgjatja/shtyrja e afatit të veprimtarisë së grupit të punës, deri në mars 2024.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, janë përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Kuvendit të Shqipërisë, propozime për ndryshime ligjore në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar dhe në ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” të ndryshuar.